



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Punimet per prishjen e objekteve konsistojne si me poshte vijon:

1.1 Te pergjitheshme

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates, Volumi-1.

1.2. Kostot e kontraktorit per mobilizimin dhe punimet e perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Kontraktorit nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine ,veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit,rrugeve te hyrjes,te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtësi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

1.3 Hyrja ne sheshin e ndertimit

Kontraktori duhet te organizoje punen per ndertimin ,mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve . Cvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Kontraktori te hynte ne Shesh.

1.4 Furnizimi me uje

Uji qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Kontraktori do te shtriye rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve . Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te pagohen nga Kontraktori. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Kontraktori duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

1.5 Furnizimi me energji elektrike

Kontraktori do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me KESH – in , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura , ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

1.6 Piketimi i punimeve

Kontraktori do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive. Kontraktori do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

Kontraktori do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.

1.7 Bashkepunimi ne zone

Puna do te behet ne zone e kuifizuar. Kontraktori duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone gjate periudhes se ndertimit.
- b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna.

E gjithë puna do te behet ne nje menyre te tille qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjetër.

1.8 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Kontraktori do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Kontraktori duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rezik per publikun.

1.9 Mbrojtja e ambientit

Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera. Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Menaxheri i Projektit, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

1.10 Transporti dhe magazinimi i materjaleve

Transporti i cdo materjali nga Kontraktori do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri.

1.11 Menaxhimi i hyrje daljeve ne kantier, sigurimi i levizjes se kembesoreve gjate ndertimit, heqja ne perfundim te punimeve e rrethimit, pastrimi i zones ne perfundim te punimeve.

1.12 Prishja e objekteve do te behet me eskavatore ne prani te pompave te ujit per te mos ndotur ambjentin.

1.13 Punimet për rrethimet e përkohshme, riparimin për dëmet e mundshme që mund t’u shkaktohen të tretëve dhe riparimimi i tubacioneve publike dhe private, ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin.

1.14 Materialet qe dalin nga prishja si muratura, copa betoni apo soletash, themele, inerte nuk do te pastrohen apo magazinohen, por vetem do te depozitohen ne vend depozitimin e miratuar nga Bashkia Lezhe.

1.15 Ngarkimi i materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin, heqje dyer, dritare dhe vetrata te nevojshme.

1.16 Ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin.

1.17 Prishje mure tulle pa pastrim. Prishja e muraturës me tulla të çfarëdo lloji dhe dimensionit, te suvatuar ose te veshur, që realizohet me mjete, ne çfarëdo lartësie ose thellësie.

1.18 Prishje soletë beton/arme, dysHEME dhe taraca. Përfshin prishjen me mjete të soletave, shtresave izoluese, pllakave, shtresave prej betoni, prishjen e soletave/dysHEMEve/taracave betonarme të çdo lloji betoni të armuar apo dimensionit, markë betoni si dhe shtresave të ndryshme që mund të ketë mbi të, që realizohet me eskavatore dhe eskavatore me gershere, fadrome dhe matrapik në çfarëdo lartësie ose thellësie.

Prishjen e trarëve konsol, sekondarë ose kryesorë (sipas gjendjes faktike në vend për çdo objekt), prishjen e kafazeve të shkalleve prej betonarmeje.

Prishje e themeleve, e dysHEMESE dhe germimi i mbushjes mbi tokë që quhet xokolatura.

Prishja e themeleve prej guri dhe betoni mbi tokë, xokol apo nentokë, shtresat prej çakelli apo zhavori, nivelimin e oborrit, shtresave të pllakave të granilit të çdo dimensionit ose mënyrë montimi që mund të gjendet në vend; që realizohet me çdo lloj mjeti dhe çfarëdo trashësie.

Transporti i mbeturinave bëhet pasi të ngarkohen me fadrome apo eskavator në kamione dhe shkarkimi i tyre në sheshin e caktuar nga Bashkia.

Prishje shtresa betoni e germime në kuotën e themelit deri në kuotën +00.